



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 437/14 Prot.

Tiranë, më 11.03.2022

VENDIM

Nr. 23, datë 11.03.2022

**“MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E
PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI NË
EDUKIMIN FIZIK E SHËNDETËSOR NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në zbatim Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, neni 38; pika 1, germa “d”, të Statutit të UST-së, neni 20 germa “ë”, në Rregulloren e Programeve të Studimit MP në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar, miratuar me Vendimin nr. 62 datë 23.04.2021, Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e datës 11.03.2022

VENDOSI :

1. Miratimin e ndryshimeve në “Rregulloren e Programeve të Studimit Master Profesional në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar në Universitetin e Sporteve të Tiranës”.
2. Ngarkohet Njësitë Kryesore të UST-së për zbatimin e saj.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AGRON KASA



NDRYSHIMET NË

“RREGULLOREN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL NË EDUKIMIN FIZIK E SHËNDETËSOR NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”

Në Rregulloren në fuqi, miratuar me Vendimin nr. 62 dt. 23.04.2021, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 5, pika 2, paragrafi i 4 (katërt) me tre nënpika ndryshohet si më poshtë: Në nënpikën e parë togfjalëshi “FSHL” zëvendësohet me togfjalëshin “UST”, pas fjalëve “Shkencat e Lëvizjes” presje, shtohet “si dhe në Fushat e Veprimtarisë Fizike të Shëndetit dhe Rekreacionit”; dhe bëhet:
 - “Kandidatët e diplomuar në UST-së, në ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes” si dhe në “Fushat e Veprimtarisë Fizike të Shëndetit dhe Rekreacionit” e kanë koeficientin 1.4”
2. Në nenin 5, pika 2, paragrafi i 4 (katërt), nënpika 2 të ndryshohet dhe riformulohet:
 - “Përzgjedhja e kandidatëve fitues të diplomuar në UST, për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”, bëhet mbi bazën e renditjes së mesatareve në programet përkatëse të ciklit të parë Bachelor . “

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AGRON KASA

